



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

1570/3
Nr. ___/Prot.

10.05
Tiranë, më ___/___/2023

URDHËR

NR. 333, DATË 10/05/2023

**“PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË BORDIT DISIPLINOR TË
DHOMËS KOMBËTARE TË NOTERISË”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të shkronjës “a”, të nenit 42, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, i ndryshuar, si dhe të urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 169, datë 10.6.2020, “Për miratimin e rregullave të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtarë të Bordit Disiplinor”,

KONSTATOJ:

Në vijim të kërkesës për shprehje interesi për t’u zgjedhur anëtar i Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë, për shkak të mbarimit të parakohshëm të mandatit të njërit prej dy anëtarëve të cilët zgjidhen nga Ministri i Drejtësisë, të publikuar më datë 30.01.2023 në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, janë paraqitur kandidaturat të cilat kanë shprehur interes sipas parashikimeve të nenit 42, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, i ndryshuar.

Në zbatim të urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.198, datë 06.03.2023, “Për ngritjen e grupit të punës për trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtarë të Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë”, është vijuar me trajtimin e kandidaturave të paraqitura dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore.

Në përfundim të verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore, të kandidaturave të paraqitura, ka rezultuar se, dokumentacioni i paraqitur nga znj. Elsonida Rama protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 513/1 Prot., datë 23.02.2023, është dërguar brenda afatit ligjor të përcaktuar në shprehjen e interesit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton, se znj. Rama ka përvojë të gjatë dhe të mirëfilltë në fushën juridike.

Konkretisht, spikat përvoja e punës si juriste në shoqëritë tregtare Kontakt; Kevin Construction; dhe AR Europroject sh.p.k.; juriste në Njësine e Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu znj. Rama ka përvojë të gjatë edhe në nivele drejtuese si, drejtor i Departamentit Juridik, Albpetrol sh.a, drejtor në shoqëritë tregtare Kontakt dhe AR Europroject sh.p.k.; drejtor në Drejtorinë e Antitrafikut dhe Migracionit në Drejtorinë e

përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Rendin dhe Sigurinë Publike, në Ministrinë e Brendshme; drejtor në Drejtorinë e të Drejtës Penale dhe Civile, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit,


për sa më sipër, bazuar në eksperiencën e gjatë dhe të provuar profesionale e sidomos në çështjet e së drejtës civile, e në aspekte të cilat lidhen me veprimtarinë që ushtrojnë noterët publik, rezulton se, znj. Rama plotëson kriteret e parashikuara në nenin 42, pika 2, të ligjit nr. 110/2018, "Për noterinë", i ndryshuar dhe Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.169, datë 10.06.2020, ndaj në këto kushte,

URDHËROJ:

1. Zgjedhjen e znj. Elsonida Rama, si anëtare të Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë.
2. Mandati znj. Elsonida Rama si anëtare e Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë, është mandat plotësues dhe përfundon në datën 31.12.2026.
3. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave dhe njoftimin e këtij urdhri, znj. Elsonida Rama, Dhomës Kombëtare të Noterisë, si dhe Shkollës së Magjistraturës.
4. Ky urdhër publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI


Ulsi Manja

